



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Raporti vjetor 2023

LUFTIMI I GJUHËS SË URREJTJES, SEKSISTE DHE GJUHËS RACISTE



Raporti vjetor 2023

LUFTIMI I GJUHËS SË URREJTJES, SEKSISTE DHE GJUHËS RACISTE

Prishtinë, dhjetor 2023



Të drejtat e autorit ©2023. **Demokraci për Zhvillim (D4D).**

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pjesëve të shkurtra me qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Punim i përgatitur nga:

Allen Meta

—

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkë financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia, dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit D4D dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, Suedisë apo Luksemburgut.

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	4
Metodologjia.....	6
Monitorimi 2022.....	8
Të gjeturat e raportit të dytë mbi Gjuhën e Urrejtjes	9
Rekomandime	17

HYRJE

Që nga viti 2020, Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) ka filluar punën në Luftimin e gjuhës së urrejtjes, disinformimit dhe të gjitha çështjeve tjera që hyjnë në kuadër integritetit të informacionit. Fenomene të tilla janë prezente gjithandej në botë, dhe si të tilla edhe Kosova po përballet me disa prej tyre, e që shpesh herë mund të janë edhe të rrezikshme për lexuesit apo shikuesit, duke qenë se krijojnë ambient polarizues brenda shoqërisë. Lajme të tilla D4D ka monitoruar në periudha të ndryshme, kur qëllimet për polarizim të shoqërisë kanë arritur edhe qëllimin, duke filluar nga disinformimi, apo edhe influenca të mediave të huaja të cilat lexohen/shikohen edhe në Kosovë.

Veçori të këtij punimi janë lajme të cilat janë monitoruar gjatë tërë vitit e që përmbajnë gjuhë të urrejtjes. Në kuadër të monitorimit ne kemi analizuar gjuhë të urrejtjes ndaj grave, komunitetit LGBTI, minoriteteve etnike dhe personave me aftësi të kufizuar.

Që nga viti i kaluar kur Instituti D4D ka monitoruar grupet e njëjta e deri më tani, nuk kemi vërejtur, mos-përdorim apo ndalje të gjuhës së urrejtjes ndaj një grupi të caktuar. Si rrjedhojë ne kemi realizuar edhe trajnime të ndryshme, qoftë me qytetarë, por edhe me gazetarë/e, që minimalisht të parandalohet në raportim një gjuhë e tillë.

Si pasoj në bazë të krahasimeve që kemi realizuar vërejmë një rritje të përdorimit të gjuhës së urrejtjes ndaj grave. Në veçanti

gjuha e urrejtjes seksiste dhe ofenduese, është rënduar edhe më shumë ndaj grave në politikë, e që padyshim është tejet e dëmshme. Për këtë kanë ndikuar edhe polarizimet e mëdha politike në mes qytetarëve, të cilët kanë rritur përdorimin edhe më shumë të gjuhës ofenduese dhe seksiste ndaj grave, nga vetë qytetarët.

Në kuadër të këtij punimi do të mund të shihni disa prej lajmeve kryesore që kanë marrë fokusin monitorues por edhe që kanë pasur arritshmëri potenciale më të lartë te lexuesit. Gjithashtu D4D do të paraqes edhe disa shembuj të gjuhës së përdorur nga vetë qytetarët në rrjete sociale, kur fokus kanë qenë gratë.

METODOLOGJIA

Ky raport përfshinë monitorimin e periudhës Janar - Nëntor të vitit 2023. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar minimalisht **100** lajme për **1** ditë. Mirëpo nga i gjithë ky monitorim, jo domosdo ka pasur çdo ditë gjuhë të urrejtjes dhe si e tillë, monitorimi nuk nënkupton edhe analizimin. Analizimi i lajmeve ka ndodhur në momentin kur kemi vërejtur apo dyshuar në përdorim të gjuhës së urrejtjes, në titull, brenda lajmit, apo edhe në komente në rrjete sociale. Gjithashtu një prej formave që D4D ka përdorur për analizim ka qenë edhe vëzhgimi i vazhdueshëm, kur polarizimet kanë shënuar ngritje në veçanti mes partive të ndryshme politike apo edhe debateve të ndryshme televizive.

Për këtë punim D4D siç ka bërë edhe në punimin e vitit 2022, njësoj edhe në këtë vit jemi angazhuar që ta qartësojmë edhe definicionin e gjuhës së urrejtjes dhe se si ne kemi konkluduar se një lajm, apo postim në rrjete sociale përmban gjuhë të urrejtjes. Si rrjedhojë kemi konsultuar edhe dokumente që hyjnë në fushën e definicionit të gjuhës së urrejtjes në kuadër të Ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut.

Për të dhënë një kornizë të unifikuar për Kombet e Bashkuara që të adresoj këtë çështje në aspekt global, strategjia e OKB-së dhe plani i aksionit mbi gjuhën e urrejtjes e definojnë gjuhën e urrejtjes si “çfarëdo komunikimi me fjalë, në të shkruar apo sjellje, që sulmon apo përdor gjuhë pezhorative apo diskriminuese me referencë tek një person apo grup mbi bazat se kush janë ata, në fjalë të tjera, duke u bazuar në religjion, etni,

nacionalitet, racë, ngjyrë, prejardhje, gjini ose ndonjë faktor tjetër identiteti”

Për të ardhur deri të analizimi i përmbajtjeve të urrejtjes ndaj një grupi të caktuar ne kemi përdorur dy platforma të cilat na kanë lehtësuar monitorimin. Këto platforma janë: **Pikasa analytics** dhe **CrowdTangle**.

MONITORIMI 2022

Në vitin 2022 më saktësisht periudhën Janar - Tetor, ne kemi monitoruar mbi 20.000 artikuj, prej të cilave janë analizuar 461. Nga ky monitorim ne kemi hasur në 60 lajme në të cilat është përdorur gjuha urrejtëse apo diskriminuese ndaj një grupi të caktuar.

Gjithashtu në po të njëjtin vit kemi bërë edhe monitorim të shënjestruar, që nënkupton gjatë një periudhe të caktuar të vitit kur ka pasur ngritje të nivelit të gjuhës së urrejtjes, jemi fokusuar specifikisht në atë kohë që ka bërë të gjejmë lajme edhe në periudha të shkurta.

Gjuha raciste, gjuha seksiste, gjuha diskriminuese dhe ofenduese ndaj 4 grupeve të lartcekura e kanë dominuar vitin e kaluar në bazë të raportit paraprak.

TË GJETURAT E RAPORTIT TË DYTË MBI GJUHËN E URREJTJES

Gjatë vitit 2023, Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) ka bërë monitorimin e rrjeteve sociale përmes platformës Pikasa analytics dhe CrowdTangle. Më saktësisht gjatë periudhës Janar - Nëntor, ne kemi hasur në shumë prej postimeve që kanë përmbajtur gjuhë të urrejtjes. Për dallim nga viti 2022 nuk kemi bërë ndarje selektive të grupeve të monitoruara, që nënkupton se të gjitha lajmet që janë monitoruar dhe analizuar janë përfshirë në një.

Gjatë kësaj periudhe kemi monitoruar lajme të shumta në kuadër të gjetjes së lajmeve të cilat kanë gjuhë të urrejtjes por edhe komenteve të cilat shkruhen në portale të ndryshme e të cilat janë me gjuhë të urrejtjes.

Në një prej portaleve është publikuar një editorial për Presidenten e Republikës së Kosovës znj. Vjosa Osmani. Editoriali si i tillë përmban gjuhë fyese e urrejtëse më shumë, se sa kritikë. Me këtë përpos që është përdorur gjuhë e urrejtjes ndaj Presidentes, gjithashtu ka pasur edhe shpërndarje të shumta që kanë ndikuar që po i njëjti artikull të paraqitet edhe më shumë te qytetarët. Si rrjedhojë vetëm artikulli në fjalë ka marrë shpërndarje nga njerëz dhe portale me lexueshmëri të lartë. Ky artikull është shpërndarë minimalisht **26** herë, pa u llogaritur shpërndarjet nga shpërndarësit e parë. Përpos artikullit të shpërndarë në këtë medie, gjithashtu shpërndarje ka pasur edhe në medie tjera, me lexueshmëri brenda dhe jashtë Kosovës.

Ajo që kemi vërejtur gjatë kësaj periudhe monitoruese është edhe se po të njëjtit artikuj duke marrë shpërndarje nga portale të ndryshme, gjithashtu marrin edhe komente të shumta, me po të njëjtën gjuhë. Si rrjedhojë nga ajo që kemi monitoruar komentet kanë përmbajtur edhe më shumë gjuhë të urrejtjes.

Vjosa do shuhet si histori turpi, është produkt njëpërdorimësh i Kurtit



De Facto

Shkurt e shqip inxhja eshte vegël nje-perdorimshe e Alpin K. 😊

~~Shkurt e shqip inxhja eshte vegël nje-perdorimshe e Alpin K.~~

Petroshni material kish me than baba i saj Milici

Përpos komenteve të lartë përmendura, edhe shumë e shumë komente tjera kanë pasur gjuhë të urrejtjes ndaj Presidentes, por gjithashtu edhe ndaj vetë autorit të këtij editoriali. Si rrjedhojë polarizimet e skajshme janë duke ndikuar tejet shumë te qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe si të tilla po ndikojnë edhe më shumë në ngritjen edhe me të lartë të gjuhës së urrejtjes.

Gjatë monitorimit të rrjeteve sociale në vitin 2023 janë hasur lajme të ndryshme ku qytetarët në komentet e tyre kanë shprehur gjuhë të urrejtjes ndaj personave të ndryshëm, mirëpo në veçanti shënjestër e gjuhës së urrejtjes janë gratë në politikë në të shumtën e rasteve.

Përpos, rastit të mësipërm, ka edhe shumë raste ku gratë në politikë janë viktime të gjuhës së urrejtjes sidomos në rrjete sociale. Mirëpo jo vetëm gratë në politikë, por edhe ato gra që momentalisht nuk janë pjesë e Kuvendit të Republikës kanë qenë pre e gjuhës së urrejtjes në rrjete sociale. Në rastin në fjalë ish-deputetja znj. Besa Gaxherri, ka folur për ngjarjet në vend dhe se si ajo e sheh Kosovën, do të thotë pa asnjë ofendim, por duke dhënë kritika drejtuar udhëheqësisë së shtetit. Si rrjedhojë znj. Gaxherri ka qenë pre e një gjuhe denigruese, ofenduese dhe urrejtëse në rrjete sociale.

Më poshtë do të mund të shihni disa prej shembujve të marrë nga disa prej portaleve dhe shkrimeve që bëhen në pjesën e komenteve nga qytetarët e Republikës së Kosovës.

ANI TI RRI BRË RAHAT TI AS PER KREVET SJE MO TRUS

Kudroooooo a Bari han Populli a?? Sipas jush

A po na nxjerr ti se jemi met qorrsokak oj veshtic ...

13w Like Reply

A shqiptqre koka kjo.Facèn e ka sikur me qen pi Pozherovaci

Këto janë vetëm disa prej komenteve që kemi paraqitur, ku janë marrë komentet me gjuhë urrejtëse nga qytetarët e Republikës së Kosovës ndaj ish-deputetes znj. Besa Gaxherri. Por, jo vetëm znj. Gaxherri ka qenë pre e një diskursi pezhorativ në rrjete sociale, nga monitorimi ne kemi vërejtur në shumë raste ku në paraqitjet e grave në emisione televizive, dhe transmetimi i drejtpërdrejtë në rrjete sociale ndikon në komentet me gjuhë urrejtëse, ku bëhet ofendime në baza gjinore, dhe fyerje nga më të ndryshmet.

Komentet gjithashtu nuk ndalen edhe për Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Përkundër raporteve paraprake që Instituti D4D ka realizuar dhe sinjalizuar se gratë në politikë janë pre e gjuhës së urrejtjes në rrjete sociale, dhe jo vetëm, komentet e qytetarëve vetëm se po shkojnë duke u ngritur edhe më tej me një gjuhë të tillë.

Shumë prej politikanëve përdorin rrjetet e tyre sociale për komunikimin me publikun, mirëpo, një shembull që kemi vërejtur gjatë kësaj periudhe monitoruese është edhe në rastet

kur statuset e grave në politikë kthehen në arenë të ofendimeve në baza gjinore e diskriminuuese nga komente të ndryshme që vërshojnë nga qytetarët.

Në shumë prej portaleve të ndryshme është ndarë një status i deputetes znj. Ganimete Musliu, i cili ka kritika ndaj pushtetit aktual. Duke marrë parasysh që në të shumtën e rasteve politikanët në profilet e tyre kanë më shumë ndjekësit apo përkrahësit e tyre, publikimi i një statusi të tyre në portale tjera ndikon polarizim tejet të lartë dhe gjuhë tejet ofenduese.

Më poshtë mund të shihni vetëm disa prej komenteve ndaj znj. Musliu, të marra në vetëm njërin nga portalet ku i është publikuar statusi i saj.

—
Oj rrugaqe o sdi qfar prind ke pas pi shum e pa edukat
rrugaqe qajo pejanja te vjen hakesh ty

—
Me kon marr e mir kjo fshatark kish pjell.e jo me met
shterp e killavet mu marr me sene qe jan satelit per to.

1y Like Reply Edited

—
Vetem shiqone qfar ftyre ka me i dh[e] ne goj e shka prit
prej ksaj kuqke

Hajt ti te lopt kqyri a kan sillazh se as ju nuk ini ma trima se kta po nese don mu ba trime shko ti e net msojn prej teje

1y Like Reply



↪ View 1 reply

Tuj kqyr punt e tjerve harrove vetin mete pa Martu

Këto janë vetëm disa prej shembujve që kemi paraqitur, duke pas parasysh që në rrjete sociale në përgjithësi ka pasur edhe më shumë komente dhe gjuhë të tillë.

Si pjesë e monitorimit që Instituti D4D ka realizuar përpos gjuhës së urrejtjes ndaj grave, gjithashtu kemi monitoruar edhe gjuhën e urrejtjes raciste që përdoret në rrjete sociale dhe jo vetëm.

Gjatë kësaj periudhe monitoruese krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, kemi vërejtur përdorim të njëjtë të gjuhës së urrejtjes raciste. Përkundër që në vitin paraprak ka pasur edhe më shumë lajme me përmbajtje të gjuhës raciste.

Një prej shembujve që do ta paraqesim më poshtë, është deputetja znj. Valentina Bunjaku e cila gjatë diskutimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pas ofendimeve verbale me deputetin Adnan Rrustemi përdor gjuhë të urrejtjes raciste dhe si e tillë merr reagime të shumta edhe nga organizata të ndryshme por edhe nga medie të ndryshme.

Luftimi i gjuhës së urrejtjes, seksiste dhe gjuhës raciste

Më poshtë mund ta shihni një prej shembujve që kemi ndarë që të paraqitet vetëm si ilustrim, në mënyrën si është paraqitur në media.

Valentina Bunjaku e LDK-së i thotë "magjup" e "majmun" deputetit të VV-së, Adnan Rustemi

Si e komentoni 🍌



Ky ishte një prej artikujve që kemi marrë vetëm sa për ilustrim të rastit të përmendur. Nga monitorimi që kemi bërë, pastaj edhe duke kërkuar manualisht, minimalisht kemi gjetur shpërndarje në 8 portale dhe media të ndryshme në Facebook e po ashtu edhe në rrjete tjera sociale. Është tejet e rëndësishme që deputetët të janë në "vijën e parë të frontit" për parandalimin dhe luftimin e gjuhës së urrejtjes raciste, ndërsa rasti në fjalë nuk është i pari që përdoret në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Duke qenë se një lajm i tillë është shpërndarë edhe ne medie tjera, ne gjatë kësaj periudhe kemi monitoruar edhe pjesën e komenteve që bëhen nga qytetarët, me atë se në shpërndarjen më të madhe të një lajmi ndikojnë ndërveprimet në të dhe si rrjedhojë mundësia e përdorimit të gjuhës së urrejtjes është e lartë.

Më poshtë mund të shihni disa prej komenteve që kemi vendosur ti paraqesim vetëm për ilustrim të lexuesve.

Per fjalen magjup u dasht mi thanë ashtu edhe siq asht Ashkali , e per fjalen Majmun , duhet organizu nje marsh ne mbrojtje te kafsheve , se me tvertet Majmunet nuk jan te ketij niveli te ulet si ky Deputeti ne fjalë

Hajt se sen sja paska nxhit as shtue paska fol veq qka asht bile edhe shka mej pas than veq e kish plotsue taman se ku me dit para lufte qysh a kan situata kogja mir e qojshin do shqiptar me shki

Këto janë vetëm disa prej komenteve që kemi paraqitur për ilustrim se si ndikon në ngritjen e një gjuhë të tillë të qytetarët, e sidomos përdorimi i po të njëjtës gjuhë nga deputetët.

REKOMANDIME

- 1 |** Fuqizimi i një grupi të organizatave dhe mediave për krijimin e një debati formal mbi mundësitë e parandalimit dhe luftimit të gjuhës së urrejtjes në rrjete sociale
- 2 |** Krijimi ose zgjerimi i mandatit të një agjencie e cila do të mbikëqyrte dhe pranonte ankesat për përdorim të gjuhës së urrejtjes, apo adresimit të tyre në instanca më të larta.
- 3 |** Krijimi dhe zgjerimi i trajnimeve mbi edukimin medial për qytetarët dhe gazetarët/et, me fokus në etikën në gazetari
- 4 |** Ngritja e kapaciteteve të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, për monitorimin dhe adresimin e gjuhës së urrejtjes ndaj portaleve.
- 5 |** Raportimi i gjuhës së urrejtjes në platformat e rrjeteve sociale nga vetë qytetarët

- 6 |** Ndjekja e modeleve të ndryshme mbi parandalimin e gjuhës diskriminuese dhe urrejtëse me fokus te gratë dhe komunitetet etnike, dhe
- 7 |** Institucionet ta kenë parasysh që nxitja e përçarjes dhe mos durimit është e sanksionuar me ligj, më saktësisht me kodin penal të Republikës së Kosovës, neni 141, të punohet në drejtim të rregullimit apo krijimit të standardeve që po të njëjtat të vlejné edhe për gjuhë të urrejtjes seksiste dhe raciste në rrjete sociale.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendim-marrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik.

Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: www.d4d-ks.org

Mbështetur nga:

